

demos  ti

Nr 101; 28.02.2017

QËLLIMI YNË



ZHVILLIMI I VENDIT


TË DREJTAT TONA

ARGJENT (13), ALTIN (13), SUZANA (13), ERIONI (12)



Disa fakte për demokracinë

Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke që do të thotë „demos“ popull dhe „kratia“ udhëheqje. Demokracia u shfaq në Athinë, ku të drejtë vote kishin vetëm burrat e pasur me prejardhje athinase. Mirëpo me kalimin e kohës dhe ndryshimet që kanë ndodhur gjatë historisë, demokracia ka ndryshuar. Tanimë të drejtë vote ka i gjithë populli, pra edhe burrat edhe gratë.



Janë dy lloje të demokracisë: demokracia e drejt-përdrejtë dhe përfaqësuese. Tek demokracia e drejt-përdrejtë populli vendos në mënyrë direkte dhe merr vendime aty për aty. Kurse, tek demokracia përfaqësuese qytetarët zgjedhin përfaqësuesit e tyre. Janë dy sisteme në demokracinë përfaqësuese, sistemi parlamentar dhe sistemi presidencial. Disa nga elementet e rëndësishme të demokracisë janë: liria, të drejtat e barabarta, toleranca, respekti.



Të drejtat tona në demokraci


Në një vend demokratik i gjithë populli ka të drejta të barabarta pa dallim feje, gjinie, race, moshe etj. Ato të drejta janë: e drejta e shkollimit, e drejta e familjes, e drejta e punës, e drejta e komunikimit, e drejta e shprehjes së mendimit, e drejta e lojës dhe e drejta për sport, etj. Pra, në demokraci kemi shumë të rëndësishëm dhe mendimet tona vlejné.



Gazetarët

KUVENDI, SHTËPIA JONË

ALMA (11), ELBENIT (12), KUSHTRIM (12), PRANVERA (12)




Funksionet dhe roli i Kuvendit si institucioni më demokratik dhe ligjvënës

Të dashur lexues, në këtë artikull do të informoheni më shumë rreth punës që Kuvendi i Republikës së Kosovës bën. Po ashtu, do t'iu tregojmë edhe për funksionet që ai si institucion ka. Ndoshta, nuk do të kemi mundësi që të cekim secilin funksion, por do të mundohemi që t'iu tregojmë funksionet elementare.

gjë e fillë, duhet që të kemi një numër të madh të qytetarëve.

Pra, këto projektligje kur miratohen nga Kuvendi, atëherë kalojnë si ligje dhe kërkohet nga ana e Qeverisë që t'i zbatojë të gjitha ato detyra që ligji i parasheh.

Populli i Kosovës ka gjithsej 120 deputetë të cilët kanë detyra dhe përgjegjësi të shumta. Por mos të harrojmë se ne i zgjedhim deputetët dhe detyra e tyre është që ta përfaqësojnë vullnetin tonë. Kur themi ne, po mendojmë të gjithë ata qytetarë të cilët i kanë votuar. Për të pasur të drejtë të votojmë për deputetët duhet të arrijmë moshën 18 vjeçare. Vota, është një e drejtë të cilën ne si qytetarë e gëzojmë kur të arrijmë këtë moshë. Në artikullin tjetër, shokët tonë të dashur, kanë për t'iu informuar më shumë rreth deputetëve dhe rolit të tyre.



Kuvendi ushtron funksion kontrollues mbi Qeverinë

Kuvendi, është një ndër ato institucione i cili ka shumë detyra dhe përgjegjësi. E para detyrë e tij është se i merr vendimet për tërë popullin, por njëkohësisht e ka për detyrë ta përfaqësoj popullin, i cili ia ka besuar votën. Po ashtu detyrë tjetër, ose më mirë të themi funksion tjetër i Kuvendit është që të miratoj projektligjet të cilat mund t'i propozojnë vet deputetët, Qeveria, Presidenti, si dhe të drejtën për të propozuar projektligje kanë edhe qytetarët. Që të mundësohet një



Grupi ynë shkruajti për temën e Kuvendit

RËNDËSIA E VOTËS

VERONA (13), ARJETA (13), ABDULMELIK (13)

Zgjedhjet në demokraci

Një proces shumë i rëndësishëm në demokraci është procesi zgjedhor. Të drejtën e votës e kanë të gjithë ata qytetarë të cilët janë mbi moshën 18 vjeçare, sepse atëherë ata janë të rritur dhe më të vetëdijshëm. Në Kosovë janë dy lloje zgjedhjesh: zgjedhjet komunale dhe zgjedhjet parlamentare. Në zgjedhjet komunale qytetarët votojnë kandidatët për kryetar të komunës dhe asambleistët, të cilët janë anëtarë të kuvendit komunal. Kurse, në zgjedhjet parlamentare populli voton kandidatët e ndryshëm për deputetë. Të votosh do të thotë të bësh ndryshimin. Votimi mund të jetë i hapur dhe i mbyllur. Kur kandidatët për deputetë votohen nga populli, votimi është i mbyllur dhe i lirë.



Autorët e artikullit



E drejta e votës



Procesi zgjedhor



Ne bashkëpunojmë



Ne duke menduar për rëndësinë e votës

DEPUTETËT E RINJË

VERONA (12), ENIS (12), RINESA (12)

Deputetët ndryshe njihen si përfaqësues të popullit, sepse populli është ai i cili i zgjedh ata me anë të votës. Këta deputetë kanë mandat 4 vjeçar. Kuvendi i Kosovës është i përbërë nga 120 deputetë, të cilët 100 prej tyre janë të kombit shqiptar, ndërsa 20 të tjerë janë të komuniteteve jo shumicë. Një qytetar për të kandiduar për deputet duhet t'i plotësoj disa kushte dhe duhet të respektoj disa rregulla si p.sh duhet të jetë mbi 18 vjeç, duhet të jetë njeri i shkolluar, por mbi të gjithë duhet të jetë shtetas i Republikës së Kosovës. Çdo qytetar i cili i plotëson këto kritere dhe dëshiron që të bëhet pjesë e Kuvendit mund ta realizoj ëndërrën e vet. Edhe disa nga shokët tonë, na thanë që në të ardhmen e afërt duan që të bëhen deputetë.



Shokët tonë duke shkruajtur plaprogramin e tyre

Unë jam Verona, këtë mandat kam kandiduar për deputete në kuadër të partisë „Ananasi“



Kandidatja për deputete

Ndërsa unë jam Enisi, po ashtu kandidat për deputet. Partia të cilën unë e përfaqësoj është partia „Molla“




Kandidati për deputet

Unë jam Rinesa, këtu kam vizatuar dhe shkruajtur disa nga detyrat dhe funksionet e Kuvendit



Kjo është detyra ime e re



Rinesa, duke bërë betimin e deputetit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Rexhep Akllapi“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VII/1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Akllap, Lipjan